



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 2880/prot.

Tiranë, më 11/07/2023

Lënda: Kthim përgjigjeje kërkesës suaj për informacion.

ZNJ. S A GAZETARE

RADIOTELEVIZIONI SHQIPTAR

Rruga "Ismail Qemali", Nr. 11, Tiranë
Të dhënat e kontaktit: e-mail:

E nderuar znj. A

Në përgjigje të pyetjeve tuaja dërguar me e-mail zyrtar, koordinatores për median dhe për të drejtën e informimit, të datës 3.7.2023, e cila është protokolluar pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit me nr. 2880 prot., datë 3.7.2023, ju sqarojmë si më poshtë:

KPK është një institucion i pavarur kushtetues i krijuar nga refomra e parë në sistemin e drejtësisë, me qëllim kryerjen e procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, rikthimin e besimit të publikut tek shteti i së drejtës dhe institucionet e reja të drejtësisë. Vettingu i gjyqtarëve dhe prokurorëve, mund të themi se ishte një proces kompleks dhe plot sfida, pasi nuk ishte kryer ndonjëherë më parë në historinë e drejtësisë shqiptare. Po ashtu pritshmëria e qytetarëve shqiptarë, si dhe e partnerëve ndërkombëtarë ishte dhe mbetet shume e lartë. Në vlerësimin tonë është punuar me përkushtim, paanshmëri, integritet dhe transparencë për të garantuar standartet e një procesi të rregullt ligjor e kushtetues. Rezultatet e punës së Komisionit janë vlerësuar pozitivisht edhe nga Bashkimi Evropian në progress raport apo dhe në takime me partenërt e tjerë ndërkombëtar.

Lidhur me pyetjen e dytë sqarojmë se pjesëmarrja e publikut në këtë process *sui generis* është parashikuar në nenin 53 të ligjit nr. 84/2016. Në këtë kuadër Komisioni ka personel të dedikuar për regjistrimin e çdo denoncimi që depozitohet fizikisht ose përmes postës elektronike të institucionit. Këto denoncime pasi regjistrohen, dhe pasi vlerësohen nga Komisioni për informacionin që përmbajnë bëhen pjesë e procesit të hetimit administrativ, duke i shërbyer

kështu vlerësimin tërësor të magjistratit. Nga viti 2017 deri në 30 qershor 2023, pranë Komisionit, janë regjistruar 6477 denoncime nga publiku, numër ky të cilin e gjeni të publikuar te regjistri i denoncimeve në faqen zyrtare kpk.al.

-Sa i takon pyetjes së tretë, ju informojmë se vetë Kushtetuta dhe ligji nr. 84/2016 kanë parashikuar garancitë ligjore që institucionet e rivlerësimit të jenë të pandikueshëm dhe të pavarur nga politika apo ndonjë organ tjetër. Komisioni garanton se nuk ka pasur asnjë ndikim politik në veprimtarinë e tij.

- Referuar pyetjes së katërt, vlerësojmë se mënyra e qasjes së disa subjekteve ndaj këtij procesi është pjesë e vështirësisë së punës së Komisionit. Pavarësisht sjelljes së disa subjekteve, Komisioni ka qëndruar i pandikuar dhe i paanshëm në vendimmarrjen e tij.

- Lidhur me pyetjen e pestë, dëshirojmë të sqarojmë se Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit ka një rol të mirëpërcaktuar në Nenin B të Aneksit Kushtetues dhe në ligjin 84/2016. Vëzhguesit ndërkombëtarë të ONM-së mbikqyrin procesin dhe monitorojnë atë në çdo fazë të tij. Ata kanë të drejtë të paraqesin gjetje dhe mendime mbi çështje që shqyrtohen nga Komisioni/Kolegji, si dhe kanë tagrin ligjor t'u rekomandojnë me shkrim Komisionerëve Publikë që të ushtrojnë ankim kundër vendimeve të Komisionit.

Me qëllim që procesi të përmbushë standardet dhe parimet kushtetuese e ligjore, ligjvënësi ka parashikuar KPK-në si shkalla e parë e vetingut, vendimet e të cilit janë të ankimueshme nga Komisioneri Publik dhe/ose subjektet e rivlerësimit. Ndërsa, si shkallë e dytë e vetingut, ka parashikuar Kolegjin e Posaçëm të Apelit, organ ky që shprehet me vendim përfundimtar për çdo ankim ndaj vendimeve të shkallës së parë.

- Lidhur me pyetjen tuaj të gjashtë, sqarojmë se, procesi i rivlerësimit kryhet mbi 3 komponentë, vlerësimin e pasurisë, vlerësimin e figurës dhe atë profesional. Kriteri që ka ndikuar më shumë në vendimet për shkarkim nga detyra të subjekteve është ai i pasurisë.

- Mbi pyetjen tuaj të fundit ju informojmë se Komisionit i kanë mbetur për të vettuar edhe 128 subjekte rivlerësimi ose 16% e listës ex-officio prej 805 subjektësh. Ju garantojmë se lista e mbetur do të përfundojë së rivlerësuar brenda mandatit kushtetues dhjetor 2024.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin, ju urojmë punë të mbarë!

SEKRETARI PËRGJITHSHËM

Edmond Verçani

